



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 248 /1 prot.

Shkodër, më 07.04.2026

**Lënda:** Mbi Vendimin nr. 05, datë 27.03.2026 të Këshillit të Qarkut Shkodër

**KËSHILLI I QARKUT SHKODËR**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ndryshuar, neni 38, pika 3 neni 77, shkronja “dh”, neni 78, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, neni 21, pika 3, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë”, të ndryshuar, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, pika 131, të VKQ Shkodër nr. 27, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Këshillit të Qarkut Shkodër”, të VKB Shkodër nr. 82, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, të VKB Vau Dejës nr. 74, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028, të VKB Fushë Arrëz nr.47, datë 26.12.2025 “Për miratimin e buxhetit afat mesëm 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”, të VKB Malësi e Madhe nr. 61, datë 24.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Malësi e Madhe”, të VKB Pukë nr. 43, datë 19.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026”, të shkresës së Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 218 prot., datë 31.03.2026 “Shkresë përcjellëse”, shqyrtoi VKQ Shkodër nr. 05, datë 27.03.2026 “Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 27, datë 23.12.2025 Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA Përfundimtare 2026-2028”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Prot. 222/3  
07.04.2026



PREFEKTI

Holta DUDA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI QARKUT SHKODËR

### V E N D I M

Nr. 222 / Prot

Shkodër me 31.03 2026

Nr. 65, Datë 27.03.2026

**“Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 27, datë 23.12.2025” Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA Përfundimtar 2026-2028 ”**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit **“Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 27, datë 23.12.2025” Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA Përfundimtar 2026-2028**”, bazuar në nenet 38 e 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.87/2025 “Per Buxhetin e Vitit 2026”, pikat 3 e 4 të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017”Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimi nr.9, datë 20.3.2018 të MF “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKQShkoder nr.27, datë 23.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA Përfundimtar 2026-2028”, pika 2 e VKQ Shkoder nr.25, datë 23.12.2025 “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2026 për Këshillin e Qarkut Shkodër”, VKB nr.82, datë 18.12.2025 të Bashkisë Shkodër, VKB nr.61, datë 24.12.2025 të Bashkisë Malësi e Madhe, VKB nr.74, datë 23.12.2025 të Bashkisë Vau Dejës, VKB nr.47, datë 26.12.2025 të Bashkisë Fushë Arrëz si dhe VKB nr.43, datë 19.12.2025 të Bashkisë Pukë, Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **14 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,**

### V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin në pikën 1/e të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin

2026, pas miratimit të Kuotës së antarësisë që Bashkitë e Qarkut Shkodër i financojnë Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026, shtesë në planin e të ardhurave në shumën 1,940,000 lekë.

- a. Kuota e Antarësisë, që bashkitë kanë planifikuar të financojnë Qarkun Shkodër për vitin 2026 do të jetë si më poshtë;

➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	600,000 lekë
➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	<b>Totali</b>	<b>1,940,000 leke</b>

- b. Shuma 1,940,000 lekë të përdoret për transfertë për investime dhe përkatsisht;

**Shtohet;**

Progr. AA033, Kap.5 Art.604, Produkti V111AAJ “Transferte e brëndshme për investime” ( me marrje VKQ) në shumën **1,940,000 lekë.**

2. Të miratohet transferimi i fondit të planifikuar në buxhetin e vitit 2026 për investimin “Rikonstruksion i godinës së Qendrës sociale BESA, Bashkia Vau Dejës“, në shumën prej 5,000,000 lekësh, nga Këshilli i Qarkut Shkodër në Bashkinë Vau Dejës. Ky fond do të përdoret për këtë investim por nga Bashkia Vau Dejës.

**Shtohet;**

Prog. AA033, Kap1,Art.604, Produkti V111AAJ “Transferte e brendshme për investimin-Rikonstruksion i godinës së Qendrës sociale BESA, Bashkia Vau Dejës“, **shuma 5,000,000 lekë**

**Pakësohet**

Prog. AA033,Kap1,Art.231,Kod Projekti P043ABH Investimi- “Rikonstruksion i godinës së Qendrës sociale BESA, Bashkia Vau Dejës“, **shuma 5,000,000 lekë.**

3. Të miratohet transferimi i fondit të planifikuar në buxhetin e vitit 2026 për investimin “Punime riparimi ne Pallatin e Kulturës Ndue Shyti , Bashkia Pukë“, në shumën prej 8,157,459 lekësh, nga Këshilli i Qarkut Shkodër në Bashkinë Pukë. Ky fond do të përdoret për këtë investim por nga Bashkia Pukë.

**Shtohet;**

Prog. AA033, Kap1,Art.604, Produkti V111AAJ “Transferte e brendshme për investimin-”Punime riparimi ne Pallatin e Kulturës Ndue Shyti, Bashkia Pukë” **shuma 8,157,459 lekë**

**Pakësohet**

Prog.AA033, Kap1, Art.231, Kod Projekti P823AAF Investimi- ”Punime riparimi ne Pallatin e Kulturës Ndue Shyti , Bashkia Pukë “, **shuma 8,157,459 lekë.**

4. Të miratohet brënda fondeve të trashëguara nga viti 2025, në artikullin 602, aktivitetin

nr.27 për Projektin: ZËRI IM, E ARDHMJA IME - Terapia e të folurit si shërbim për integrimin social-si më poshtë;

Nr.27	Projekti; ZËRI IM E ARDHMJA IME	Produkti VIII1AAD
a)	<b>ZËRI IM, E ARDHMJA IME</b> Terapia e të folurit si shërbim për integrimin social-edukativ të fëmijëve në Njësinë Administrative Shkodër	
I	<b>Përshkrim i shkurtër i Situatës së projektit:</b>	
	Në territorin e Njësisë Administrative Shkodër, shumë fëmijë që vijnë nga familje në vështirësi socio-ekonomike përballen me vështirësi në zhvillimin e të folurit dhe komunikimit. Mungesa e aksesit në shërbime të specializuara, si terapia e të folurit, përbën një pengesë serioze për zhvillimin e tyre arsimor, social dhe emocional. Aktualisht, në territorin e Bashkisë Shkodër ky shërbim ofrohet në kapacitete shumë të kufizuara në sistemin publik, duke krijuar lista të gjata pritjeje dhe duke lënë jashtë trajtimit shumë fëmijë që kanë nevojë për ndërhyrje të hershme. Fëmijët që përjetojnë vështirësi në komunikim shpesh përballen me probleme në ndjekjen e procesit mësimor, në integrimin social dhe në ndërtimin e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët. Në mungesë të ndërhyrjes së hershme, këto vështirësi mund të ndikojnë negativisht në vetëbesimin, performancën shkollore dhe përfshirjen sociale të tyre. Në këtë kontekst, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, në bashkëpunim me institucionet lokale dhe strukturat komunitare, synon të ofrojë terapi të të folurit për fëmijët vulnerabël dhe të krijojë një model të qëndrueshëm ndërhyrjeje që mund të shërbejë si bazë për zhvillimin e politikave sociale në nivel qarku.	
II	<b>-Synimi i Projektit</b>	
	Objekti kryesor i projektit është përmirësimi i aftësive të komunikimit dhe integritit social-edukativ të fëmijëve vulnerabël përmes ofrimit të terapisë së të folurit dhe forcimit të mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional për identifikimin dhe mbështetjen e rasteve në nevojë. Projekti synon gjithashtu të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit të familjeve dhe komunitetit për rëndësinë e ndërhyrjes së hershme në zhvillimin e të folurit dhe komunikimit tek fëmijët.	
III	<b>Aktivitetet kryesore të projektit</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ofrimi i terapisë së të folurit për fëmijët përfitues nga një terapistë e specializuar, në ambientet e SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.</li> <li>➤ Realizimi i vlerësimeve profesionale fillestare dhe përfundimtare për matjen e progresit të fëmijëve.</li> <li>➤ Organizimi i sesioneve informuese dhe orientuese për prindërit dhe kujdestarët mbi rëndësinë e zhvillimit të komunikimit dhe mbështetjes në familje.</li> <li>➤ Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve didaktike dhe informuese për ushtrime praktike në shtëpi.</li> <li>➤ Bashkëpunimi me qendrat shëndetësore, kopshtet, shkollat dhe qendrat komunitare për identifikimin dhe referimin e rasteve që kanë nevojë për terapi të të folurit.</li> <li>➤ Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi nevojat për këtë shërbim në territor, me qëllim planifikimin e politikave të ardhshme sociale në nivel qarku.</li> </ul>	
	<b>Përcaktimi i fushave të bashkëpunimit për vitet e ardhshme</b>	
b)	<b>Rezultatet e pritshme</b>	
	Përmirësim i matshëm i aftësive të të folurit dhe komunikimit për të paktën 15 fëmijë përfitues. Rritje e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve në procesin arsimor dhe në ndërveprimet sociale. Ndërgjegjësim më i madh i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e ndërhyrjes së hershme në zhvillimin e komunikimit. Krijimi i një modeli pilot ndërhyrjeje që mund të përdoret për zgjerimin e shërbimit të terapisë së të folurit në nivel qarku.	

c) <b>Aktorët e mundshëm.</b>		<b>Kontributet e mundshme</b>		
		Këshilli i Qarkut Shkodër – koordinimi institucional dhe mbështetja e projektit. SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri – ofrimi i shërbimit të terapisë së të folurit dhe menaxhimi i rasteve. Qendrat shëndetësore dhe qendrat institucionet arsimore – identifikimi dhe referimi i rasteve.		
<b>Shpenzimet e llogarituara, buxheti i Projektit, Viti 2026 në 000/lekë</b>				
<b>Shpenzimet analitike</b>		<b>Totali</b>	<b>Nga kjo;</b>	
			<b>Paga, sig.</b>	<b>Sh. Operative</b>
			<b>Transferta</b>	
A1	Terapiste e të folurit	180,000		180,000
A2	Mat. pune (printime, kancelari etj)	45,000		45,000
A3	Material vizibiliteti	15,000		15,000
A4	Monitorim dhe raportim	10,000		10,000
A5	Spot TV	20,000		20,000
A6	Marketing Social & Produksio Montazh	30,000		30,000
<b>TOTALI</b>		<b>310,000</b>		<b>310,000</b>
<b>e) Periudha e zbatimit të projektit Gjatë vitit 2026</b>		<b>Përgatiti realizimin e projektit Drejtoria e Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Fshati SOS Dega Shkodër</b>		

Fondet e tjera të mbetura të papërdorura në Art.602,Kap.1,do të mbeten në të njëjtin zëra buxheti.

5. Të miratojë transferimin e fondit të mbetur gjendje në llogarinë e thesarit nga projekti ADRIATICAVES shuma 761,164 lekë, nga llogaria e dedikuar e projektit ADRIATICAVES, tek të ardhurat e Këshillit të Qarkut Shkodër si më poshtë;

**Shtohet;**

Prog. AA033, Kap5,Art.606, Produkti V111AAJ “Transferte ndaj individëve“, shuma 761,164 lekë

**Pakësohet**

Prog. AA033,Kap2,Art.230,Kod Projekti P476AAN Projekti ADRATICAVES“, shuma 761,164 lekë.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
7. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

